



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 137, Datë 25.06.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME NR. 322, SERIA F15, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 159 DATË 28.12.2015**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 15 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 19 pika 1, gërma “a”, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.06.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 322, Seria F15,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE, me Vendimin nr. 159, datë 28.12.2014 ka licencuar shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5 vjeçar, dhe subjekti është mbajtës i licencës nr. 322, Seria F15.
- Subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 400 Prot., datë 17.05.2018, ka bërë më dije se shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k ka ndryshuar emrin e subjektit dhe atë tregtar si më poshtë:
Emri i ri i subjektit bëhet: “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA”
Emri i ri tregtar bëhet: “ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA”
- Në vijim të korrespondencës sipërcituar, ERE me shkresën nr. 400/1 Prot., datë 25.05.2018, i ka bërë më dije subjektit se ndryshimet e bëra emrit të subjektit dhe të reflektuara në QKR, duhet të refletohen edhe në Licencën e Furnizimit të Energjisë Elektrike me nr. 322 Seria F15. Si rezultat subjekti ka detyrimin që në zbatim të nenit 43 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e

Energjisë Elektrike”; nenit 15 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, të aplikojë në ERE për modifikimin e licencës.

- Sa më sipër subjekti “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k, me shkresën nr. 436 Prot. i ERE, datë 07.06.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së Furnizimit të energjisë elektrike duke kërkuar ndryshimin e emrit të mbajtësit të saj nga “Le Trading Albania” sh.p.k, në “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.
- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, si më poshtë:
 - Neni 9, pika 1, Formati dhe dokumentacioni për aplikim,
 - gërma “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar;
 - gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), plotësuar;
 - gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) plotësuar;
 - Neni 8 pika 2,

Aplikuesi do të kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin A të kësaj rregulloreje, në shumën 30 000 lekë, plotësuar.
 - Neni 15, pika 4, gërma “a” : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës : Plotësuar.
 - Neni 15, pika 4, gërma “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence : Pa Plotësuar.
 - Neni 15, pika 4, gërma c: Miratimi i modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Nuk aplikohet në këtë rast kjo kërkesë e rregullores, pasi nga subjekti është bërë vetëm ndryshimi i emrit.
 - Neni 15, pika 4, gërma d: Ndikimet e pritshme të modifikimit të licensës ndaj detyrimeve të të licencuarit. Modifikimi që po kryhet nuk prek detyrimet e të licencuarit sa i përket mbarëvajtjes së punës për llojin e aktivitetit.
 - Neni 15, pika 4, gërma “e”: Të ketë plotësuar pagesat e rregullimit në ERE : Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së Furnizimit të Energjisë Elektrike nr. 322, Seria F15, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159 datë 28.12.2015.

2. Në titull dhe përmbajtje të licencës nr. 322, Seria F15, emërtimi “Le Trading Albania” sh.p.k., do të zëvendësohet me emërtimin “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.